



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORI

Nr. 520 Prot.

Vlorë, më 08.03.2020

URDHËR
Nr. 20 datë 08.03.2020

"PËR PEZULLIMIN E PROCESIT MËSIMOR NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË NGA DATA 10-23 MARS 2020 DHE ZËVENDËSIMIN E TYRE NË DITËT NË VAZHDIM"

Në mbështetje të ligjit neni 39 të nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, neni 31, Urdhërit Nr. 135, datë 09.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Urdhërit Nr. 91, datë 09.03.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Për arsye parandaluese të përhapjes së virusit COVID-19 (Coronavirus), në cilësinë e Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

URDHËROJ:

1. Pezullimin e procesit mësimor në të gjitha njësitë kryesore dhe njësitë e tjera të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në datat 10 deri më 23 mars 2020. Mësimi do të filloi në datën 24 mars.
2. Dekanët dhe Shefat e departamenteve të marrin masa për përgatitjen e grafikut të zëvendësimit të procesit mësimor.
3. Senati Akademik dhe Rektorati do të mblidhen në rastet se Rektori e gjykon se ka çështje emergjente për tu diskutuar.
4. Të gjitha takimet e parashikuara nga ASCAL do të pezullohen deri në një urdhër të dytë, veç takimeve të datës 10. 03. 2020.
5. Ky Urdhër përcillet për zbatim të gjitha njësive kryesore dhe njësive bazë të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
6. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof. Dr **ROLAND ZISI**

